UDHËZUES

PËR MENAXHIMIN E PROJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR [**PIKSH**]

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1. Qëllimi
Neni 2. Objekti
Neni 3. Baza ligjore
Neni 4. Fusha e zbatimit
Neni 5. Përkufizime
Neni 6. Llojet e projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor

KAPITULLI II
KUSHTET DHE KRITERET E PRANUESHMËRISË

Neni 7. Kushtet e pranueshmërisë për aplikantin
Neni 8. Kriteret materiale të pranueshmërisë së aplikantit dhe projekt-propozimit
Neni 9. Partneritetet
Neni 10. Parimet e përgjithshme për pranueshmërinë e shpenzimeve
Neni 11. Kategoritë e shpenzimeve të pranueshme
Neni 12. Kushtet për pranueshmërinë e shpenzimeve
Neni 13. Shpenzimet e papranueshme
Neni 14. Verifikimi i pranueshmërisë së shpenzimeve

KAPITULLI III
CIKLI, PARIMET DHE STRUKTURAT E MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE

Neni 15. Cikli i menaxhimit të projekteve PIKSH
Neni 16. Parimet e procesit të menaxhimit të projekteve PIKSH
Neni 17. Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e projekteve PIKSH

KAPITULLI IV
FAZAT E PROCESIT TË MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE PIKSH

Neni 18. Shpallja e thirrjes
Neni 19. Shqyrtimi administrativ i projekt-propozimeve
Neni 20. Vlerësimi shkencor, teknik dhe financiar
Neni 21. Miratimi i projekteve për financim
Neni 22. Marrëveshja e financimit
Neni 23. Zbatimi i projektit
Neni 24. Monitorimi dhe raportimi

KAPITULLI V
KUADRI BUXHETOR DHE FINANCIAR I PROGRAMIT PIKSH

Neni 25. Burimet e financimit të Programit PIKSH
Neni 26. Buxheti i projektit, financimi dhe bashkëfinancimi
Neni 27. Administrimi financiar i projektit

KAPITULLI VI
KONFLIKTI I INTERESIT DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 28. Konflikti i interesit
Neni 29. Konfidencialiteti

KAPITULLI VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 30. Interpretimi dhe zbatimi i Udhëzuesit
Neni 31. Çështje të paparashikuara
Neni 32. Hyrja në fuqi

KAPITULLI VIII
ANEKSET E UDHËZUESIT

Lista e Anekseve për aplikantët është si më poshtë:

Aneksi 1. Formulari standard i aplikimit
Aneksi 2. Modeli standard i buxhetit të projektit
Aneksi 3. Deklarata e angazhimit
Aneksi 4. Deklarata e mosfinancimit të dyfishtë
Aneksi 5. Plani i detajuar i punës. Kalendari i zbatimit të projektit

Lista e Anekseve për Vlerësuesit dhe AKKSHI është si më poshtë:

Aneksi 6. Deklarata e konfliktit te interest dhe paanshmerise
Aneksi 7. Formulari i vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar nga ekspertët
Aneksi 8. Matrica e kritereve dhe pikëzimit të vlerësimit
Aneksi 9. Formati standard i raportit teknik të progresit dhe raportit përfundimtar
Aneksi 10. Formati standard i raportit financiar
Aneksi 11. Lista e shpenzimeve të pranueshme dhe të papranueshme
Aneksi 12. Lista e treguesve të performancës dhe monitorimit (KPI)
Aneksi 13. Lista e dokumenteve të detyrueshme për aplikim
Aneksi 14. Lista e kontrollit administrativ të aplikimeve (Administrative Check List)
Aneksi 15. Struktura e kodit të projektit PIKSH

HYRJE

Programi i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në Shqipëri filloi të zbatohet në vitin 2019 në kuadër të Paktit për Universitetin, nëpërmjet financimit nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) të projekteve të infrastrukturës kërkimore shkencore të IAL-ve publike. Ky program synon zbatimin e suksesshëm të politikave në këtë fushë, duke kontribuar në standartizimin e sistemit institucional të Kërkimit Shkencor (KSH) dhe në orientimin e kërkimit shkencor drejt një ekonomie konkuruese dhe inovative. Udhëzuesi PIKSH është hartuar në përputhje me prioritetet strategjike të Republikës së Shqipërisë për zhvillimin e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit. Ai mbështet zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, të Strategjisë së Specializimit Inteligjent (Smart Specialisation Strategy – S3), si dhe harmonizimin me parimet dhe objektivat e Zonës Evropiane të Kërkimit (European Research Area – ERA).

Ky Udhëzues ka për qëllim të përcaktojë rregullat, procedurat dhe standardet për administrimin e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), i cili financohet nga Ministria e Arsimit përmes Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në përmbushje të misionit dhe funksioneve të saj ligjore për mbështetjen, zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit.
Përmes këtij pogrami, AKKSHI synon të kontribuojë në krijimin, modernizimin, zgjerimin dhe funksionalizimin e infrastrukturave kërkimore, si një instrument strategjik për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe teknike të organizatave kërkimore, përmirësimin e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së kërkimit shkencor, nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjen e aksesit të komunitetit shkencor në pajisje, platforma dhe shërbime kërkimore të standardeve bashkëkohore, progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në tabelën evropiane të rezultateve të inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI.

Udhëzuesi synon të garantojë një proces transparent, objektiv, konkurrues dhe të bazuar në meritë për planifikimin, aplikimin, vlerësimin, financimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e investimeve në infrastrukturën e kërkimit shkencor, duke siguruar përdorim efektiv dhe të qëndrueshëm të fondeve publike dhe përputhshmëri me prioritetet kombëtare dhe evropiane të kërkimit dhe inovacionit.

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky Udhëzues përcakton rregullat, procedurat, kriteret dhe përgjegjësitë për administrimin e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, duke përfshirë procedurat e shpalljes së thirrjeve, aplikimit, shqyrtimit administrativ, vlerësimit shkencor dhe teknik, miratimit, financimit, zbatimit, monitorimit dhe mbylljes së projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor, të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).
2. Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të sigurojë:
   a. transparencë, objektivitet dhe barazi në procesin e financimit të projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor;
   b. përdorimin efikas, efektiv dhe me integritet të fondeve publike të dedikuara për zhvillimin e infrastrukturës së kërkimit;
   c. zhvillimin, modernizimin dhe konsolidimin e infrastrukturës kombëtare të kërkimit shkencor, në përputhje me prioritetet kombëtare të kërkimit, inovacionit dhe specializimit inteligjent (S3);
   d. rritjen e cilësisë, kapaciteteve dhe konkurrueshmërisë së institucioneve të kërkimit dhe arsimit të lartë;
   e. nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, ndërkombëtar dhe me sektorin privat, si dhe përdorimin e përbashkët dhe aksesin e hapur në infrastrukturat e financuara, kur kjo është e zbatueshme;
   f. garantimin e monitorimit sistematik të realizimit të projekteve, vlerësimit të rezultateve dhe ndikimit të investimeve publike në zhvillimin e sistemit kombëtar të kërkimit shkencor dhe inovacionit;
   g. progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në tabelën evropiane të rezultateve të inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI.
3. Ky Udhëzues zbatohet për të gjitha projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor që financohen nga AKKSHI në kuadër të Programit Kombëtar të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor.

Neni 2
Objekti

1. Objekti i këtij Udhëzuesi është përcaktimi i procedurave, kritereve, dokumentacionit, roleve dhe përgjegjësive që rregullojnë administrimin e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, duke përfshirë:
   a. planifikimin dhe shpalljen e thirrjeve për financimin e projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor;
   b. kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve, partnerëve dhe projekteve;
   c. procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e kërkuar;

d. procedurat e shqyrtimit administrativ dhe të verifikimit të pranueshmërisë së aplikimeve;
e. procedurat e vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar të projekt-propozimeve, sipas parimeve të transparencës, paanshmërisë dhe meritës;
f. procedurat e miratimit dhe financimit të projekteve fituese;
g. lidhjen, administrimin dhe ndryshimin e marrëveshjeve të financimit;
h. procedurat e zbatimit, monitorimit, raportimit, kontrollit dhe auditimit të projekteve të financuara;
i. mekanizmat për pezullimin, ndërprerjen ose rikuperimin e fondeve në rast të mosrespektimit të kushteve të financimit;
j. procedurat për mbylljen administrative dhe financiare të projekteve, si dhe vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit të investimeve në zhvillimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor.

2. Ky Udhëzues synon të sigurojë një proces të standardizuar, transparent dhe të bazuar në meritë për financimin dhe menaxhimin e projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dokumentet strategjike kombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

Neni 3
Baza ligjore

1. Ky Udhëzues mbështetet në legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, si dhe në aktet rregullatore dhe dokumentet strategjike që rregullojnë fushën e kërkimit shkencor, inovacionit dhe financimit publik, në veçanti:
   a. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
   b. Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore përkatëse;
   c. Ligjin nr. 109/2024, datë 19.12.2024, "Për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore përkatëse;
   d. Strategjinë Kombëtare të Specializimit Inteligjent (Smart Specialisation Strategy – S3), në fuqi;
   e. Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, në fuqi;
   f. Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
   g. Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", ose legjislacionin në fuqi që rregullon prokurimin publik, kur është i zbatueshëm;
   h. Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
   i. Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", kur është i zbatueshëm;
   j. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 607, datë 31.08.2016, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", i ndryshuar;
   k. Udhëzimi nr. 10, datë 04.06.2026 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të financimit mbi baza konkurruese të programeve apo të projekteve kërkimore të paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë, institucionet e krijuara me ligj të posaçëm, institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, publike dhe jopublike".

l. Urdhrin e Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit Nr. 270, datë 12.06.2026 "Për miratimin e planit të veprimit me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në tabelën evropiane të rezultateve të inovacionit, me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI";
m. aktet në fuqi për etikën dhe integritetin në shkencë dhe kërkim shkencor;
n. aktet në fuqi për shkencën e hapur, aksesin e hapur dhe menaxhimin e të dhënave kërkimore;
o. Ligjin nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale";
p. legjislacionin për pronësinë intelektuale;
q. sipas rastit, me kërkesat, detyrimet dhe standardet që rrjedhin nga Reform and Growth Facility (RGF) dhe aktet përkatëse të zbatimit të saj;
r. dokumentet programore, udhëzimet dhe standardet e Bashkimit Evropian për infrastrukturat e kërkimit, për aq sa janë të zbatueshme dhe nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar.

2. Në rast të ndryshimit të legjislacionit ose të miratimit të akteve të reja ligjore dhe nënligjore, dispozitat e këtij Udhëzuesi zbatohen në përputhje me aktet në fuqi.

Neni 4
Fusha e zbatimit

1. Ky Udhëzues zbatohet për të gjitha projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor që financohen, bashkëfinancohen ose administrohen nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor.
2. Dispozitat e këtij Udhëzuesi zbatohen për të gjitha fazat e ciklit të projektit, duke përfshirë:
   a. planifikimin dhe shpalljen e thirrjeve për aplikim;
   b. aplikimin dhe dorëzimin e projekt-propozimeve;
   c. shqyrtimin administrativ dhe verifikimin e pranueshmërisë;
   d. vlerësimin shkencor, teknik dhe financiar;
   e. miratimin dhe financimin e projekteve;
   f. nënshkrimin dhe administrimin e marrëveshjeve të financimit;
   g. zbatimin, monitorimin, raportimin, kontrollin dhe auditimin e projekteve;
   h. vlerësimin përfundimtar dhe mbylljen administrative e financiare të projekteve.
3. Ky Udhëzues është i detyrueshëm për Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), ekspertët e përfshirë në proceset e shqyrtimit, vlerësimit dhe monitorimit, si dhe për të gjitha institucionet dhe subjektet e pranueshme për financim në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe dokumenteve të thirrjes për aplikim.
4. Dispozitat e këtij Udhëzuesi zbatohen pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe kushtet specifike të programeve ose instrumenteve të bashkëfinancuara nga Bashkimi Evropian ose donatorë të tjerë ndërkombëtarë, për aq sa këto nuk bien në kundërshtim me legjislacionin kombëtar.

Neni 5
Përkufizime

1. Në kuptim të këtij Udhëzuesi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
   a. **AKKSHI**– Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, institucioni përgjegjës për administrimin, financimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit.
   b. **Bordi i Administrimit (BA) i AKKSHI** - është organi kolegjial vendimmarrës i AKKSHI. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e tij përcaktohen në aktin themelues të Agjencisë dhe në legjislacionin në fuqi.
   c. **Programi i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH)** – programi kombëtar i financimit që mbështet krijimin, zhvillimin, modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, në përputhje me prioritetet kombëtare të kërkimit dhe inovacionit.
   d. **Infrastrukturë e kërkimit shkencor** – pajisjet, instrumentet shkencore, laboratorët, koleksionet, burimet biologjike, bazat e të dhënave, platformat dixhitale, rrjetet kërkimore, qendrat e specializuara dhe çdo burim tjetër fizik ose virtual që përdoret për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore dhe inovative.
   e. **Projekt i infrastrukturës së kërkimit shkencor** – një projekt që synon krijimin, modernizimin, zgjerimin, integrimin ose përmirësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, i financuar në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor.
   f. **Aplikant** – institucioni ose konsorciumi i institucioneve të pranueshme që paraqet një projekt-propozim për financim.
   g. **Institucion përfitues** – institucioni ose konsorciumi me të cilin AKKSHI lidh marrëveshjen e financimit për zbatimin e projektit.
   h. **Partner** – institucioni publik ose jopublik, vendas ose i huaj, që kontribuon në realizimin e projektit në përputhje me marrëveshjen e partneritetit.
   i) **Projekt-propozim** – dokumentacioni teknik, shkencor dhe financiar i paraqitur nga aplikanti për të kërkuar financim.
   i. **Ekspert vlerësues** – person me kualifikim dhe përvojë në fushën përkatëse, i ngarkuar nga AKKSHI për të kryer vlerësimin shkencor, teknik ose financiar të projekt-propozimeve.
   j. **Konflikt interesi** – çdo situatë në të cilën interesat personale, profesionale ose financiare të një eksperti, anëtari të komisionit ose personi tjetër të përfshirë në procesin e vlerësimit mund të ndikojnë ose të perceptohen se ndikojnë në paanshmërinë e vendimmarrjes.
   k. **Shpenzime të pranueshme** – shpenzimet që përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzues, dokumentet e thirrjes dhe marrëveshjen e financimit.
   l. **Marrëveshja e financimit** – kontrata e lidhur ndërmjet AKKSHI dhe institucionit përfitues, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve për zbatimin e projektit.
   m. **Monitorim** – procesi i ndjekjes sistematike të progresit teknik, shkencor, administrativ dhe financiar të projektit gjatë gjithë periudhës së zbatimit, për të verifikuar përmbushjen e objektivave, rezultateve dhe detyrimeve kontraktore.
   n. **Raport përfundimtar** – dokumenti teknik dhe financiar që paraqitet nga institucioni përfitues në përfundim të projektit, në të cilin pasqyrohen aktivitetet e realizuara, rezultatet e arritura, përdorimi i fondeve dhe ndikimi i investimit.

o. **Akses i hapur (Open Access)** – parimi sipas të cilit infrastruktura, të dhënat ose rezultatet e kërkimit të financuara me fonde publike vihen në dispozicion të komunitetit shkencor, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, marrëveshja e financimit dhe rregullat e përdorimit të infrastrukturës.

2. Për termat që nuk janë përkufizuar në këtë Udhëzues, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për shkencën dhe kërkimin shkencor, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 6
Llojet e infrastrukturave të kërkimit shkencor

1. Në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) financohen projekte që synojnë krijimin, zhvillimin, modernizimin, integrimin dhe rritjen e kapaciteteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor, në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit të kërkimit, inovacionit dhe specializimit inteligjent.
2. Projektet e financueshme mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:
   a. **Krijimin e infrastrukturës së re të kërkimit**, përfshirë laboratorë, qendra kërkimore, stacione eksperimentale, observatorë dhe infrastruktura të tjera shkencore;
   b. **Modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese**, nëpërmjet rinovimit, përditësimit ose zëvendësimit të pajisjeve, instrumenteve dhe sistemeve teknologjike;
   c. **Zgjerimin e kapaciteteve të infrastrukturës së kërkimit**, përmes shtimit të pajisjeve, hapësirave, laboratorëve ose funksionaliteteve të reja;
   d. **Pajisjen me instrumente dhe pajisje shkencore**, përfshirë instrumente laboratorike, aparatura analitike, sisteme matëse dhe pajisje të tjera të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore;
   e. **Zhvillimin e infrastrukturës dixhitale të kërkimit**, duke përfshirë platforma kërkimore dixhitale, infrastruktura kompjuterike me performancë të lartë (HPC), shërbime cloud, sisteme të ruajtjes dhe menaxhimit të të dhënave shkencore, repositorë dhe infrastrukturë për shkencën e hapur;
   f. **Krijimin ose zhvillimin e laboratorëve dhe objekteve kërkimore me interes kombëtar**, që ofrojnë kapacitete dhe shërbime kërkimore për komunitetin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e kërkimit, sektorin publik dhe, sipas rastit, sektorin privat;
   g. **Krijimin ose zhvillimin e platformave kërkimore dhe rrjeteve të infrastrukturës së kërkimit**, që mbështesin përdorimin e përbashkët të burimeve, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe integrimin në rrjetet evropiane dhe ndërkombëtare të infrastrukturës së kërkimit.
3. Në varësi të objektivave të thirrjes, AKKSHI mund të financojë edhe projekte për integrimin, ndërveprueshmërinë dhe rrjetëzimin e infrastrukturave ekzistuese të kërkimit, me synim rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre dhe aksesit nga komuniteti shkencor.
4. Kategoritë e projekteve, prioritetet tematike, kufijtë financiarë dhe kushtet specifike të financimit përcaktohen në dokumentacionin e çdo thirrjeje për aplikim

KAPITULLI II

KUSHTET DHE KRITERET E PRANUESHMËRISË

Neni 7
Kushtet e pranueshmërisë për aplikantin

1. Të drejtën për të aplikuar për financim në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) e kanë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, këtë Udhëzues dhe dokumentacionin e thirrjes për aplikim.
2. Aplikimi mund të paraqitet:
   a. nga një institucion i vetëm - institucion publik i arsimit të lartë; ose
   b. nga një partneritet i përbërë nga dy ose më shumë institucione të arsimit të lartë, ku të paktën njëri nga partnerët duhet të jetë institucion publik i arsimit të lartë dhe njëkohësisht institucioni koordinator.
3. Aplikanti duhet:
   a. të jetë i regjistruar dhe të ushtrojë veprimtarinë e tij në përputhje me kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi;
   b. të mos jetë në procedura falimentimi, likuidimi, shpërbërjeje ose në ndonjë procedurë tjetër ligjore që cënon aftësinë për zbatimin e projektit;
   c. të ketë kapacitete të përshtatshme administrative, teknike dhe financiare për menaxhimin dhe zbatimin e projektit;
   d. të caktojë një person përgjegjës për projektin, i cili shërben si pikë kontakti me AKKSHI dhe përgjigjet për koordinimin e aktiviteteve të projektit;
   e. të ketë kapacitete institucionale për administrimin, mirëmbajtjen, funksionimin dhe përdorimin afatgjatë të infrastrukturës së financuar;
   f. të sigurojë bashkëfinancimin ose kontributin financiar apo në natyrë, kur kjo kërkohet në dokumentacionin e thirrjes;
   g. të mos ketë detyrime të papërmbushura financiare, kontraktuale ose raportuese ndaj AKKSHI nga projekte të mëparshme të financuara, përveç rasteve kur këto janë në proces të rregullt zgjidhjeje;
   h. të garantojë saktësinë, plotësinë dhe vërtetësinë e informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në aplikim.
4. Një institucion publik i arsimit të lartë mund të marrë pjesë në më shumë se një aplikim, si aplikant ose partner, me kusht që secili projekt të jetë i dallueshëm në objekt, qëllim dhe plan investimi dhe të mos krijojë mbivendosje të financimit për të njëjtat aktivitete ose asete infrastrukturore.

Neni 8
Kriteret e pranueshmërisë së projekt-propozimit

1. Projekt-propozimi i paraqitur në kuadër të programit PIKSH duhet të plotësojnë kriteret materiale të pranueshmërisë të përcaktuara në këtë nen.
2. **Projekt-propozimi duhet**:
   a. të jetë në përputhje me objektivat dhe fushën e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor;

b. të justifikojë nevojën për krijimin, zhvillimin, modernizimin ose zgjerimin e infrastrukturës së propozuar, duke evidentuar ndikimin në rritjen e kapaciteteve kërkimore;
c. të jetë në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin dhe Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3), sipas rastit;
d. të paraqesë një plan të qartë teknik dhe financiar për realizimin e investimit, përfshirë afatet, burimet dhe mënyrën e menaxhimit të projektit;
e. të përcaktojë mënyrën e përdorimit të infrastrukturës, përfshirë aksesin nga komuniteti shkencor dhe përdorues të tjerë të mundshëm, në përputhje me parimet e përdorimit të përbashkët dhe aksesit të hapur;
f. të përmbajë një plan për qëndrueshmërinë e infrastrukturës pas përfundimit të financimit, duke përfshirë mirëmbajtjen, kostot e funksionimit dhe kapacitetet institucionale për menaxhimin e saj;
g. të demonstrojë ndikimin e pritshëm të investimit në zhvillimin e kërkimit shkencor, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional, përmirësimin e cilësisë së kërkimit dhe integrimin në rrjete kombëtare ose ndërkombëtare të kërkimit, kur është e zbatueshme.

3. Përveç kritereve të parashikuara në këtë Udhëzues, AKKSHI mund të përcaktojë në thirrjen për aplikime kritere të tjera specifike të pranueshmërisë, të cilat janë të detyrueshme për aplikantët.

Neni 9
Partneritetet

1. Projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor mund të realizohen nga një institucion i vetëm përfitues ose nëpërmjet partneriteteve ndërmjet dy ose më shumë institucioneve dhe subjekteve të pranueshme, në përputhje me objektivat e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor dhe kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes për aplikim.
2. Partneritetet synojnë të nxisin përdorimin e përbashkët të burimeve kërkimore, rritjen e kapaciteteve institucionale, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe optimizimin e investimeve publike në infrastrukturën e kërkimit shkencor.
3. Partneriteti mund të përfshijë institucione të arsimit të lartë publik, partnerë ndërkombëtarë, institucionet jo publike të arsimit të lartë ose institucione të tjera të kërkimit shkencor dhe subjekte të tjera të pranueshme sipas legjislacionit në fuqi dhe dokumentacionit të thirrjes.
4. Në rastin e aplikimit në partneritet, institucion koordinator duhet të jetë institucion publik i arsimit të lartë, i cili përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në dokumentacionin e thirrjes për aplikim.
5. Institucioni koordinator ka përgjegjësi për:
   a. përfaqësimin e konsorciumit në marrëdhëniet me AKKSHI;
   b. paraqitjen e aplikimin dhe dokumentacionit përkatës;
   c. koordinimin, zbatimin e projektit dhe administrimin e marrëveshjes së financimit;
   d. përgjigjet për raportimin teknik dhe financiar ndaj AKKSHI, pa cënuar përgjegjësitë e partnerëve sipas marrëveshjes së partneritetit.

4. Marrëdhëniet ndërmjet partnerëve rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje partneriteti, e cila duhet të përcaktojë, të paktën:
   a. rolin dhe përgjegjësitë e secilit partner;
   b. kontributin e secilit partner në projekt;
   c. mënyrën e menaxhimit dhe përdorimit të infrastrukturës së financuar;
   d. të drejtat dhe detyrimet lidhur me pajisjet, asetet dhe rezultatet e krijuara;
   e. mënyrën e aksesit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës pas përfundimit të projektit.
6. Partneritetet duhet të demonstrojnë vlerë të shtuar krahasuar me një aplikim individual, veçanërisht në drejtim të:
   a. rritjes së kapaciteteve kërkimore;
   b. shmangies së mbivendosjes së investimeve;
   c. rritjes së përdorimit të infrastrukturës;
   d. krijimit të rrjeteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
7. Partnerët janë bashkërisht përgjegjës për zbatimin e detyrimeve të tyre sipas marrëveshjes së partneritetit dhe marrëveshjes së financimit, ndërsa institucioni koordinator mban përgjegjësinë kryesore për koordinimin dhe raportimin ndaj AKKSHI.
8. Kushtet specifike për përbërjen e partneriteteve, numrin minimal të partnerëve, rolin e tyre dhe kriteret e pranueshmërisë përcaktohen në dokumentacionin e çdo thirrjeje për aplikim.
5. Konsorciumi mund të përfshijë institucione vendase dhe, kur parashikohet në dokumentacionin e thirrjes, partnerë ndërkombëtarë, në përputhje me objektivat e projektit dhe legjislacionin në fuqi.
6. Infrastruktura e kërkimit e financuar në kuadër të Programit PIKSH vendoset në institucionin publik të arsimit të lartë që plotëson kushtet infrastrukturore, teknike dhe organizative për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e saj, si dhe siguron akses të hapur, transparent, të drejtë dhe jodiskriminues për përdoruesit, sipas politikës së aksesit të miratuar dhe në përputhje me parimet e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA). Vendndodhja e infrastruturës përcaktohet në marrëveshjen e partneritetit.

Neni 10
Parimet e përgjithshme për pranueshmërinë e shpenzimeve

1. Në kuadër të këtij Udhëzuesi, Programi i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) konsiderohet si një instrument financimi publik për zhvillimin, forcimin dhe qëndrueshmërinë e kapaciteteve infrastrukturore të kërkimit shkencor dhe jo si një skemë financimi për realizimin e projekteve kërkimore të mirëfillta.
2. Financimi në kuadër të PIKSH synon krijimin, zgjerimin, modernizimin, përmirësimin, funksionalizimin dhe përdorimin afatgjatë të infrastrukturave të kërkimit shkencor, duke garantuar:
3. a) përdorimin efektiv të fondeve publike;
   b) rritjen e kapaciteteve kërkimore kombëtare;
   c) aksesin e komunitetit shkencor në infrastrukturat e financuara;
   d) qëndrueshmërinë teknike, institucionale dhe financiare të investimeve të realizuara.
4. Në kuadër të PIKSH financohen vetëm shpenzimet që janë:
   a) të nevojshme për realizimin e objektivave të projektit;
   b) të arsyeshme dhe proporcionale me natyrën dhe shkallën e investimit;

c) të parashikuara në buxhetin e miratuar të projektit;
d) të dokumentuara dhe të verifikueshme;
e) në përputhje me këtë Udhëzues, dokumentacionin e thirrjes për aplikim dhe marrëveshjen e financimit.

Neni 11
Kategoritë e shpenzimeve të pranueshme

1. Financimi në kuadër të Programit PIKSH jepet në formën e grantit publik për infrastrukturën e kërkimit shkencor. Si rrjedhojë, janë të pranueshme vetëm shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me objektin e grantit dhe janë të domosdoshme për krijimin, modernizimin, zgjerimin, funksionalizimin dhe përdorimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor.
2. Përfituesi është përgjegjës për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të projektit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Udhëzues dhe marrëveshjen e financimit.

Neni 12
Kushtet për pranueshmërinë e shpenzimeve

1. Për t'u konsideruar të pranueshme, shpenzimet duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:
   a. të jenë kryer brenda periudhës së zbatimit të projektit, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe në marrëveshjen e financimit;
   b. të jenë të përfshira në buxhetin e miratuar;
   c. të mbështeten me dokumentacion financiar, teknik dhe administrativ të rregullt;
   d. të jenë realizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar, kontrollin dhe prokurimin publik, kur është i zbatueshëm.
2. Në dokumentacionin e çdo thirrjeje për aplikim përcaktohen, sipas natyrës dhe objektit të investimit, kategoritë specifike të shpenzimeve të pranueshme, kufijtë financiarë, si dhe kërkesat procedurale për paraqitjen, dokumentimin dhe verifikimin e tyre, duke respektuar kriteret dhe parimet e përcaktuara në këtë Udhëzues.

Neni 13
Shpenzimet e papranueshme

1. Nuk financohen shpenzime që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të projektit të infrastrukturës së kërkimit shkencor, ose që nuk përputhen me kërkesat e këtij Udhëzuesi, thirrjes për aplikim dhe marrëveshjes së financimit.
2. Konsiderohen të papranueshme, ndër të tjera:
   a. shpenzimet e kryera përpara fillimit të periudhës së zbatimit të projektit, përveç rasteve të përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes;
   b. blerja e pajisjeve ose aktiveve që nuk lidhen me objektin e projektit;
   c. shpenzimet operative të zakonshme të institucionit përfitues, që nuk lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e infrastrukturës së financuar;
   d. pagat dhe shpërblimet e stafit të përhershëm të institucionit, përveç rasteve kur lejohet shprehimisht;

e. blerja, qiraja ose mirëmbajtja e ambienteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me investimin;
f. blerja e automjeteve, mobilieve të zyrës dhe pajisjeve administrative të zakonshme;
g. interesa, penalitete, gjoba dhe detyrime të tjera financiare për shkak të mosrespektimit të detyrimeve ligjore ose kontraktuale;
h. shpenzime të financuara nga burime të tjera publike ose programe të tjera financimi;
i. shpenzime të pambështetura me dokumentacion justifikues ose të paverifikueshme;
j. shpenzime instalimi, transporti, trajnimi të stafit, etj.
k. çdo shpenzim tjetër që nuk është i përcaktuar si i pranueshëm në dokumentacionin e thirrjes për aplikim, që nuk është i parashikuar në strukturën e buxhetit dhe kategoritë e shpenzimeve të përcaktuara në formularin financiar standard të AKKSHI, apo i ndryshëm nga ato të përcaktuara në nenin 11 të këtij Udhëzuesi.

KAPITULLI III

CIKLI, PARIMET DHE STRUKTURAT E MENAXHIMT TË PROJEKTEVE PIKSH

Neni 14
Cikli i menaxhimt të projekteve PIKSH

1. Cikli i realizimit të projekteve PIKSH përfshin të gjitha fazat e menaxhimit të një investimi në infrastrukturën e kërkimit shkencor, nga shpallja e thirrjes për aplikim dhe procesi i përzgjedhjes, deri te financimi, zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi përfundimtar i rezultateve. Çdo fazë realizohet nga strukturat përgjegjëse të përcaktuara, në përputhje me parimet e transparencës, meritokracisë, efektivitetit të përdorimit të fondeve publike dhe qëndrueshmërisë së investimit shkencor.

   Fazat dhe strukturat përgjegjëse

Faza e ciklit të projektit	Përshkrimi i procesit	Struktura përgjegjëse
0. Programimi	Përcaktimi i fondit, numrit, kohëzgjatjes dhe prioriteteve	AKKSHI/ Ministria
1. Hartimi dhe publikimi i thirrjes për aplikim	Përcaktimi i objektivave, kritereve, afateve, dokumentacionit të kërkuar dhe kushteve të financimit për projektet PIKSH.	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare (DPK), në koordinim me strukturat drejtuese të AKKSHI-së
2. Sesionet informuese	Organizimi i takimeve dhe komunikimeve lidhur me shpërndarjen e informacionit dhe qartësinë e thirrjes	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare
3. Afati për pyetje	Procesimi i pyetjeve dhe kërkesave për asistence, si edhe hartimi i dokumentave sqarues	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare
4. Paraqitja dhe regjistrimi i projekt-propozimeve	Institucionet aplikante paraqesin projekt-propozimet dhe dokumentacionin shoqërues brenda afatit të përcaktuar. Aplikimet regjistrohen dhe administrohen.	Institucionet aplikuese; AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare
5. Kontrolli administrativ i aplikimeve	Verifikimi i përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, dokumentacionit të detyrueshëm, kërkesave të thirrjes dhe pranueshmërisë së kostove.	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare dhe strukturat administrative/financiare përgjegjëse
6. Vlerësimi shkencor, teknik dhe financiar	Shqyrtimi i projekt-propozimeve sipas kritereve të përcaktuara: rëndësia shkencore, nevoja strategjike, cilësia teknike, kapaciteti institucional,	Ekspertë të jashtëm të pavarur të angazhuar nga AKKSHI; mbështetur nga Drejtoria e Programeve Kombëtare

	qëndrueshmëria dhe efektiviteti financiar.	
7. Përgatitja e raporteve të vlerësimit dhe renditja e projekteve	Përgatitja e raporteve individuale të ekspertëve, konsolidimi i rezultateve dhe hartimi i renditjes së projekt-propozimeve sipas pikëve të marra.	Ekspertët vlerësues; AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare
8. Përgatitja e metodologjisë për vlerësimin e projekteve fituese	Konsolidimi i rezultateve, renditja e projekt-propozimeve, përcaktimi i vlerës së financimit dhe kushteve eventuale të zbatimit, përgatitja e metodologjisë për vlerësimin e projekteve fituese.	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare, në bashkëpunim me strukturat financiare
9. Prezantimi i projekteve përpara BA nga drejtuesit e projekteve	IAL/ Drejtuesit e projekteve prezantojnë përpara Bordit të Administrimit të AKKSHI konceptin e propozimit të tyre.	IAL/ Drejtuesit e projekteve
10. Vendimmarrja për financim	Shqyrtimi i rekomandimit dhe miratimi i financimit të projekteve në përputhje me rezultatet e vlerësimit, metodologjine e vleresimit sipas prioriteteve strategjike dhe fondet e disponueshme.	Bordi i Administrimit i AKKSHI-së
11. Lidhja e marrëveshjes së financimit	Pas perfundimit te afateve te ankimimit, hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes ndërmjet AKKSHI-së dhe institucionit përfitues, duke përcaktuar detyrimet, afatet, financimin dhe kërkesat për raportim.	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare; Sektori Juridik/Financiar; Institucioni përfitues
12. Zbatimi i projektit PIKSH	Realizimi i aktiviteteve të miratuara: blerja/instalimi i pajisjeve, ngritja ose modernizimi i infrastrukturës, funksionalizimi dhe përdorimi shkencor i saj.	Institucioni përfitues / Koordinatori i projektit; Ekipi i projektit
13. Monitorimi i zbatimit të projektit	Ndjekja e progresit teknik dhe financiar, verifikimi i realizimit të objektivave, përdorimit të fondeve dhe përputhshmërisë me marrëveshjen e financimit.	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare dhe Struktura e Monitorimit dhe Vlerësimit
14. Raportimi teknik dhe financiar	Paraqitja e raporteve periodike dhe përfundimtare mbi aktivitetet e realizuara, rezultatet, treguesit e performancës dhe përdorimin e fondeve.	Institucioni përfitues / Drejtuesi i projektit; shqyrtim nga AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare dhe strukturat financiare
15. Vlerësimi përfundimtar dhe mbyllja e projektit	Vlerësimi i rezultateve të arritura, ndikimit të investimit, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së infrastrukturës së financuar.	AKKSHI – Drejtoria e Programeve Kombëtare; Struktura e Monitorimit dhe Vlerësimit; ekspertë teknikë kur është e nevojshme

Neni 15
Parimet e procesit të menaxhimit të projekteve PIKSH

1. Procesi i realizimit të projekteve në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), nga aplikimi, vlerësimi dhe përzgjedhja e projekt-propozimeve deri në financim, zbatim, monitorim, raportim dhe vlerësim përfundimtar, bazohet në parimet e mëposhtme:
   a. **Parimi i transparencës dhe informimit të barabartë** – procedurat, kriteret, afatet, rezultatet e vlerësimit dhe vendimmarrja publikohen dhe administrohen në mënyrë transparente, duke garantuar akses të barabartë për të gjithë subjektet e interesuara;
   b. **Parimi i konkurrencës së hapur dhe trajtimit të barabartë** – të gjithë aplikantët që plotësojnë kriteret e përcaktuara kanë mundësi të barabarta për pjesëmarrje, vlerësim dhe përfitim nga financimi;
   c. **Parimi i cilësisë, meritës dhe vlerësimit të pavarur** – përzgjedhja e projekteve bazohet në cilësinë shkencore dhe teknike, nevojën strategjike, realizueshmërinë, ndikimin e pritshëm dhe vlerësimin objektiv nga ekspertë të pavarur;
   d. **Parimi i integritetit, paanshmërisë dhe shmangies së konfliktit të interesit** – të gjitha fazat e procesit realizohen në përputhje me standardet etike dhe administrative, duke garantuar pavarësi në vlerësim dhe vendimmarrje;
   e. **Parimi i efektivitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve publike** – financimi dhe zbatimi i projekteve synojnë përdorimin optimal të burimeve publike dhe maksimizimin e vlerës së krijuar nga investimi në infrastrukturën kërkimore;
   f. **Parimi i qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit të infrastrukturës** – projektet duhet të garantojnë përdorimin afatgjatë, mirëmbajtjen, zhvillimin dhe aksesin efektiv në infrastrukturën e financuar edhe pas përfundimit të periudhës së financimit;
   g. **Parimi i bashkëpunimit dhe aksesit të hapur** – realizimi i projekteve promovon bashkëpunimin ndërinstitucional, ndërdisiplinor dhe, kur është e zbatueshme, aksesin e komunitetit shkencor dhe partnerëve të tjerë në kapacitetet e krijuara;
   h. **Parimi i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies** – institucionet përfituese mbajnë përgjegjësi për zbatimin e projektit, përdorimin e fondeve sipas qëllimit të miratuar, arritjen e rezultateve dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit dhe monitorimit;
   i. **Parimi i monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm** – zbatimi i projekteve shoqërohet me monitorim periodik të progresit teknik dhe financiar, me qëllim garantimin e realizimit të objektivave dhe menaxhimin efektiv të burimeve;
   j. **Parimi i përputhshmërisë strategjike dhe ndikimit afatgjatë** – projektet duhet të kontribuojnë në prioritetet kombëtare të kërkimit shkencor, zhvillimit të kapaciteteve kërkimore dhe integrimit në Sistemin Evropian të Kërkimit (ERA);
   k. **Parimi i menaxhimit të bazuar në rezultate** - Projektet planifikohen, zbatohen dhe vlerësohen mbi bazën e objektivave, rezultateve dhe treguesve të matshëm të performances;
   l. **Parimi i menaxhimit të shëndoshë financiar** - Fondet administrohen sipas parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, duke garantuar përdorimin e tyre të ligjshëm, të arsyeshëm dhe të dokumentuar;
   m. **Parimi i parandalimit të mashtrimit, konfliktit të interesit dhe parregullsive** - Gjatë gjithë ciklit të projektit zbatohen masa për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe trajtimin e mashtrimit, konfliktit të interesit dhe parregullsive;

n. **Parimi i mosfinancimit të dyfishtë** - I njëjti shpenzim, aktivitet, pajisje ose rezultat nuk mund të financohet më shumë se një herë nga burime publike ose programe të tjera financimi.

2. Zbatimi i këtyre parimeve garanton një proces të integruar, transparent dhe të bazuar në cilësi për realizimin e projekteve PIKSH, duke siguruar që investimet në infrastrukturën e kërkimit shkencor të gjenerojnë vlerë të qëndrueshme për institucionet kërkimore, komunitetin shkencor dhe zhvillimin kombëtar.

Neni 16
Strukturat përgjegjëse për menaxhimin e projekteve PIKSH

1. Strukturat përgjegjëse për procesin e menaxhimit të projekteve PIKSH janë:
   a. njësia përgjegjëse në AKKSHI-së, e ngarkuar për administrimin dhe koordinimin e programit PIKSH;
   b. ekspertët e jashtëm të pavarur, të angazhuar për realizimin e vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar të projekt-propozimeve.
   c. Bordi i Administrimit i AKKSHI si organi përgjegjës për vendimin përfundimtar për financimin e projekt-propozimeve
2. Këto struktura ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me dispozitat e këtij Udhëzuesi, dokumentacionin e thirrjes për aplikim dhe legjislacionin në fuqi;
3. Njësia përgjegjëse të AKKSHI-së është përgjegjëse për administrimin dhe koordinimin e procesit, konkretisht për:
   a. organizimin e procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimeve;
   b. kryerjen e kontrollit administrativ të aplikimeve;
   c. sigurimin e përputhshmërisë së procesit me kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara;
   d. administrimin e komunikimit me vlerësuesit gjatë procesit të vlerësimit;
   e. koordinimin e punës së ekspertëve të jashtëm dhe administrimin e raporteve të vlerësimit;
   f. përgatitjen e dokumentacionit për vendimmarrjen për financim.
4. Ekspertët e jashtëm të pavarur, janë përgjegjës për realizimin e vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar të projekt-propozimeve. Ata angazhohen mbi bazën e një thirrjeje të hapur për shprehje interesi, e cila publikohet dhe përcakton kriteret e përzgjedhjes, fushat e ekspertizës, dokumentacionin e kërkuar, mënyrën e aplikimit dhe afatet për paraqitjen e shprehjeve të interesit. Ekspertët e jashtëm duhet të plotësojnë, ndër të tjera, kriteret e mëposhtme:
   a. të kenë kualifikim dhe përvojë të dokumentuar shkencore ose profesionale në fushën përkatëse;
   b. të kenë njohuri dhe eksperiencë në zhvillimin, përdorimin ose menaxhimin e infrastrukturave të kërkimit shkencor, sipas natyrës së thirrjes;
   c. të kenë integritet profesional dhe të mos ndodhen në situata konflikti interesi me aplikantët ose projekt-propozimet që do të vlerësojnë;
   d. të jenë të gatshëm të respektojnë kërkesat për konfidencialitet dhe paanshmëri të procesit të vlerësimit.
5. Përzgjedhja e ekspertëve kryhet nga AKKSHI në bazë të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur dhe përputhshmërisë së profilit të ekspertit me nevojat e procesit të vlerësimit. Në procesin e përzgjedhjes së ekspertëve të jashtëm, AKKSHI prioritizon angazhimin e ekspertëve vlerësues me përvojë të dëshmuar ndërkombëtare,

përfshirë ekspertë nga diaspora shkencore shqiptare dhe ekspertë të huaj, me qëllim garantimin e një vlerësimi të pavarur, cilësor dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit të infrastrukturave të kërkimit shkencor.

6. Ekspertët e jashtëm nuk marrin pjesë në vendimmarrjen për financim, por raportet dhe rekomandimet e tyre shërbejnë si bazë profesionale për procesin e vlerësimit dhe për vendimmarrjen institucionale.
7. Bordi i Administrimit i AKKSHI-së është organi që merr vendimin përfundimtar për financimin e projekt-propozimeve, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KAPITULLI IV

FAZAT E PROCESIT TË MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE PIKSH

Neni 17
Shpallja e thirrjes

1. Struktura përgjegjëse në AKKSHI harton thirrjen për aplikime në përputhje me fondet e miratuara dhe prioritetet strategjike të kërkimit shkencor dhe inovacionit dhe të programit PIKSH.
2. Thirrja miratohet nga organi kompetent i AKKSHI (Bordi I Administrimit) dhe publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë, si dhe në mjete të tjera të komunikimit institucional, me qëllim garantimin e transparencës dhe aksesit të barabartë në informacion.
3. Thirrja për aplikime përmban, të paktën:
a. objektivin dhe qëllimin e financimit;
b. prioritetet tematike ose fushat e mbështetura, kur është e zbatueshme;
c. subjektet e pranueshme për aplikim;
d. fondin e përgjithshëm të disponueshëm dhe vlerën maksimale të financimit për projekt;
e. periudhën e zbatimit të projekteve;
f. kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e vlerësimit;
g. dokumentacionin e kërkuar për aplikim;
h. mënyrën dhe afatin e dorëzimit të aplikimeve;
i. procedurat e shqyrtimit, vlerësimit dhe miratimit;
j. rregullat për komunikimin me aplikantët dhe publikimin e rezultateve;
k. informacionin për kontakt dhe mënyrën e kërkimit të sqarimeve.
4. AKKSHI mund të publikojë dokumente shoqëruese të thirrjes, përfshirë udhëzime për aplikantët, formularët e aplikimit, formatet e buxhetit, modelet e deklaratave dhe dokumente të tjera të nevojshme për administrimin e procesit.
5. Dokumentacioni i thirrjes për aplikim hartohet dhe publikohet nga AKKSHI dhe përbën bazën rregullatore për paraqitjen, shqyrtimin, vlerësimin, financimin dhe monitorimin e projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor. Dokumentacioni i thirrjes përcakton në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e aplikantëve, kushtet e financimit, afatet e aplikimit, mënyrën e komunikimit me AKKSHI, si dhe rregullat që zbatohen gjatë gjithë procesit të aplikimit dhe vlerësimit. Dokumentacioni i thirrjes përfshin, sipas rastit:
a. njoftimin e thirrjes për aplikim;
b. udhëzuesin për aplikantët;
c. formularin e aplikimit;
d. formularin e buxhetit dhe udhëzimet për hartimin e tij;
e. kriteret e pranueshmërisë dhe kriteret e vlerësimit;
f. dokumente të detyrueshme që duhet të paraqiten nga aplikantët;
g. formatet e deklaratave dhe dokumenteve që kërkohen gjatë procesit të aplikimit;
h. modelin e marrëveshjes së financimit;
i. dokumente të tjera që AKKSHI i vlerëson të nevojshme për zbatimin e thirrjes.
4. Të gjitha dokumentet e thirrjes publikohen në faqen zyrtare të AKKSHI dhe bëhen të aksesueshme për të gjithë aplikantët gjatë gjithë periudhës së aplikimit.

5. Në rast të ndryshimeve ose sqarimeve të dokumentacionit të thirrjes, AKKSHI publikon njoftimin përkatës në faqen zyrtare. Çdo ndryshim ose sqarim bëhet pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes dhe është detyrues për të gjithë aplikantët nga data e publikimit.

Neni 18
Shqyrtimi i performancës së propozimeve

1. Shqyrtimi i performancës i aplikimeve kryhet nga struktura përgjegjëse për PIKSH në AKKSHI pas përfundimit të afatit të aplikimit dhe ka për qëllim kontrollin e përmbushjes së kërkesave formale dhe kushteve të pranueshmërisë.
2. Shqyrtimi i performances përfshin kontrollin dhe verifikimin e:
   a. respektimit të afatit dhe mënyrës së dorëzimit të aplikimit;
   b. plotësimit të formularit të aplikimit dhe dokumentacionit shoqërues;
   c. statusit performancës dhe pranueshmërisë së aplikantit;
   d. përmbushjes së kërkesave për partneritetet, kur është e zbatueshme;
   e. përputhshmërisë së dokumentacionit me kërkesat e thirrjes;
3. Kontrolli i performancës nuk përfshin vlerësimin e cilësisë shkencore, teknike ose strategjike të projektit.
4. Në rast se gjatë kontrollit të performancës konstatohet mungesë e dokumentacionit shoqërues si: shkresë zyrtare përcjellëse e aplikimit, vërtetimeve të gradave e titujve, CV e drejtuesit dhe kopja digjitale e aplikimit, nëse performanca nuk është funksionale, AKKSHI i kërkon aplikantit plotësimin e dokumentacionit dhe përcjelljen e tij brenda fateve të përcaktuara ligjore.
5. Plotësimi i dokumentacionit lejohet vetëm për elemente administrative dhe formale dhe nuk mund të përdoret për:
   a. ndryshimin e objektivave të projektit;
   b. ndryshimin e aktiviteteve kryesore të propozuara;
   c. ndryshimin e përmbajtjes teknike ose shkencore të projektit;
   d. rritjen ose ndryshimin e buxhetit të paraqitur.
4. Nëse aplikanti nuk paraqet dokumentacionin plotësues brenda afatit të përcaktuar, aplikimi konsiderohet i papranueshëm dhe refuzohet administrativisht.
5. Aplikimi refuzohet administrativisht kur:
   a. është dorëzuar pas përfundimit të afatit të përcaktuar;
   b. aplikanti nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë;
   c. mungon dokumentacioni i detyrueshëm dhe ai nuk plotësohet brenda afatit të përcaktuar;
   d. aplikimi nuk është paraqitur sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar;
   e. informacioni ose dokumentacioni i paraqitur rezulton i rremë, i pasaktë ose mashtrues;
6. Vendimi për refuzimin dokumentohet dhe i komunikohet aplikantit, duke përcaktuar arsyet e refuzimit. Refuzimi lidhet vetëm me mosplotësimin e kërkesave formale dhe të pranueshmërisë dhe nuk përbën vlerësim të cilësisë shkencore ose teknike të projektit.

Neni 19
Vlerësimi shkencor, teknik dhe financiar i projekt-propozimeve

1. Vlerësimi shkencor, teknik dhe financiar i projekt-propozimeve konsiston në analizën e integruar të rëndësisë shkencore, realizueshmërisë teknike dhe efektivitetit financiar të investimit të propozuar, me qëllim garantimin e përzgjedhjes së projekteve që sigurojnë vlerë të shtuar për zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të kërkimit shkencor dhe përdorimin efikas të fondeve publike.
2. **Vlerësimi shkencor** shqyrton rëndësinë, nevojën dhe vlerën kërkimore të infrastrukturës së propozuar dhe analizon nëse investimi I propozuar kontribuon në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore. Nëpërmjet vlerësimit shkencor shqyrtohet nevoja dhe rëndësia e infrastrukturës së propozuar, kontributi I saj në forcimin e kapaciteteve kërkimore kombëtare, si dhe vlera e shtuar që investimi pritet të sjellë për zhvillimin e kërkimit shkencor. Ai përfshin vlerësimin e:
   a. rëndësisë së infrastrukturës për fushën shkencore përkatëse;
   b. nevojës së argumentuar nga komuniteti kërkimor;
   c. kontributit në rritjen e cilësisë dhe kapacitetit të kërkimit shkencor;
   d. përputhshmërisë me prioritetet kombëtare të kërkimit, inovacionit dhe specializimit inteligjent;
   e. potencialit për të mbështetur projekte kërkimore konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
   f. mundësisë së përdorimit nga komuniteti më I gjerë shkencor.
3. **Vlerësimi teknik** shqyrton cilësinë, përshtatshmërinë dhe realizueshmërinë teknike të investimit të propozuar. Ai synon të përcaktojë nëse infrastruktura e propozuar është teknikisht e realizueshme, nëse plotëson kërkesat e nevojshme për instalim dhe funksionim dhe nëse aplikanti disponon kapacitetet e nevojshme për përdorimin efektiv të saj dhe përfshin vlerësimin e:
   a. përshtatshmërisë së pajisjeve, sistemeve ose platformave të propozuara;
   b. specifikimeve teknike dhe përputhshmërisë me standardet përkatëse;
   c. kapaciteteve institucionale dhe ambienteve ekzistuese për instalimin dhe përdorimin e infrastrukturës;
   d. planit të instalimit, kalibrimit, testimit dhe funksionalizimit;
   e. kapaciteteve njerëzore për përdorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës;
   f. planit të menaxhimit dhe qëndrueshmërisë teknike pas përfundimit të financimit.
4. **Vlerësimi financiar** shqyrton arsyeshmërinë, proporcionalitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike të kërkuara për investimin. Ai synon të përcaktojë nëse investimi I propozuar është I justifikuar nga pikëpamja ekonomike dhe financiare, nëse kostot e parashikuara janë të arsyeshme dhe proporcionale me rezultatet e pritshme, si dhe nëse garanton përdorim efektiv dhe të qëndrueshëm të fondeve publike dhe përfshin vlerësimin e:
   a. përputhshmërisë së buxhetit me objektivat dhe aktivitetet e projektit;
   b. justifikimit të kostove të propozuara;
   c. arsyeshmërisë së çmimeve dhe vlerës së investimit;
   d. raportit ndërmjet kostos së investimit dhe përfitimit të pritshëm;
   e. planit për kostot operative dhe mirëmbajtjen afatgjatë;
   f. shmangies së mbivendosjes së financimeve ose investimeve ekzistuese.

5. Procesi i vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar realizohet nga ekspertë të jashtëm të pavarur, të angazhuar nga AKKSHI sipas procedurave të përcaktuara në këtë Udhëzues.
6. Në përfundim të procesit të vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar ekspertët e vlerësimit hartojnë dhe dorëzojnë në AKKSHI raportet individuale të vlerësimit për çdo projekt-propozim të vlerësuar.
7. Strukturat përgjegjëse të AKKSHI-së administrojnë dhe koordinojnë procesin e vlerësimit, sigurojnë zbatimin e kritereve dhe metodologjisë së vlerësimit, përmbledhin rezultatet e vlerësimit dhe përgatisin rekomandimin për financim që i paraqitet BA të AKKSHI.
8. Strukturat e vlerësimit veprojnë në përputhje me parimet e pavarësisë, paanshmërisë, konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesave.

Neni 20
Renditja e projekteve dhe metodologjia për vlerësimin e projekteve fituese

1. Pas përfundimit të vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar të projekt-propozimeve, strukturat përgjegjëse të AKKSHI-së administrojnë rezultatet e vlerësimit, përgatisin raportin përmbledhës dhe realizojnë renditjen e projekt-propozimeve sipas pikëve të marra dhe rezultateve të procesit të vlerësimit.
2. Projekt-propozimet renditen sipas rezultateve të vlerësimit dhe pikëve të përfituara, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzues dhe në dokumentacionin e thirrjes për aplikim.
3. Mbi bazën e renditjes së projekt-propozimeve, rezultateve të vlerësimit dhe fondeve të disponueshme për financim, strukturat përgjegjëse të AKKSHI-së përcaktojne vlerën e financimit dhe kushteve eventuale të zbatimit.
4. AKKSHI përgatit metodologjinë për vlerësimin e projekteve fituese, duke marrë në konsideratë analizën e aplikimeve të administruara, pikët, fondet e disponueshme dhe kushtet eventuale të zbatimit.
5. Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI i përcjell Bordit të Administrimit të AKKSHI dokumentacionin e pregatitur, për t`u shqyrtuar në mbledhjen e thirrur për miratimin e financimit të projekteve fituese.

Neni 21
Vendimi për financim, njoftimi dhe lidhja e kontratës së financimit

1. Bordi i Administrimit i AKKSHI-së shqyrton dhe merr vendim për financimin ose mosfinancimin e projekt-propozimeve të paraqitura, mbi bazën e metodologjisë për vlerësimin e projekteve fituese, pas prezantimit nga IAL/ Drejtuesit e projekteve te konceptit te propozimit të tyre – bazuar në rezultatet e procesit të vlerësimit, prioriteteve strategjike dhe fondeve të miratuara për Programin e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH).
2. Vendimi i Bordit të Administrimit përcakton projektet e miratuara për financim, institucionet përfituese dhe vlerën e financimit të akorduar për cdo projekt.
3. AKKSHI publikon rezultatet e procesit të përzgjedhjes në faqen zyrtare, pas marrjes së vendimit nga BA, duke përfshirë 23erfor e projekteve të financuara, institucionet përfituese dhe vlerën e financimit të miratuar, në përputhje me parimet e transparencës, aksesit në informacion dhe kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.

3. AKKSHI njofton të gjithë aplikantët për rezultatin e procesit të vlerësimit dhe vendimmarrjes.
   a. Për aplikantët, projekt-propozimet e të cilëve nuk janë miratuar për financim, njoftimi përmban informacion mbi rezultatin përfundimtar të aplikimit dhe, kur parashikohet në dokumentacionin e thirrjes, informacion për arsyet kryesore të mospërzgjedhjes.
   b. Aplikantët kanë të drejtë të paraqesin ankim ndaj rezultateve të procesit të vlerësimit dhe vendimmarrjes, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes për aplikim. Ankesa shqyrtohet nga AKKSHI në lidhje me respektimin e procedurave të përcaktuara për administrimin, vlerësimin dhe vendimmarrjen. Ankesa nuk mund të synojë rivlerësimin e pavarur të meritës shkencore të projekt-propozimit, përveç rasteve kur konstatohen shkelje procedurale që kanë ndikuar në procesin e vlerësimit. Rezultati i shqyrtimit të ankesës i komunikohet aplikantit sipas afatit të përcaktuar në dokumentacionin e thirrjes.
4. AKKSHI lidh marrëveshjen e financimit me institucionin përfitues për projektet e miratuara për financim në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), e cila përcakton kuadrin ligjor, financiar dhe teknik për zbatimin e projektit. Marrëveshja e financimit, ndër të tjera, përmban:
   a. objektin, qëllimin dhe kohëzgjatjen e projektit;
   b. vlerën e financimit të miratuar dhe kushtet e përdorimit të fondeve;
   c. të drejtat dhe detyrimet e palëve;
   d. planin e zbatimit, kërkesat për monitorim dhe raportim;
   e. kërkesat për menaxhimin financiar, kontrollin dhe dokumentimin e shpenzimeve;
   f. kushtet për ndryshime, pezullim ose përfundim të marrëveshjes, kur është e nevojshme.
   4. Institucioni përfitues është përgjegjës për nënshkrimin e marrëveshjes së financimit 24erfor afatit të përcaktuar nga AKKSHI/NASRI. Mosnënshkrimi I marrëveshjes 24erfor këtij afati mund të sjellë humbjen e të drejtës për financim, sipas kushteve të përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes.
   5. Ndryshimet në kushtet e zbatimit të projektit trajtohen sipas përcaktimeve të marrëveshjes së financimit. Ndryshimet madhore që prekin objektivat, komponentët kryesorë, afatet ose strukturën financiare të miratuar mund t'I nënshtrohen miratimit të 24erforman Administrimit të AKKSHI-së, me propozim të strukturave përgjegjëse dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në marrëveshjen e financimit. Ndryshimet e tjera miratohen nga strukturat përgjegjëse të AKKSHI/NASRI-së, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në këtë marrëveshje

Neni 22
Zbatimi i projekteve PIKSH

1. Projektet e miratuara për financim në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) fillojnë zabtimin e tyre pas nënshkrimit të marrëveshjes së financimit ndërmjet AKKSHI dhe institucionit përfitues, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

2. Institucioni përfitues është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve të projektit, menaxhimin 25erfor dhe financiar, koordinimin e burimeve njerëzore, si dhe garantimin e arritjes së objektivave dhe rezultateve të përcaktuara.
3. Menaxhimi I projektit përfshin organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve, administrimin e burimeve financiare dhe njerëzore, ndjekjen e afateve të zbatimit, garantimin e cilësisë së rezultateve dhe sigurimin e funksionalitetit të infrastrukturës së financuar.
4. Zbatimi I projektit përfshin, sipas natyrës dhe objektit të investimit:
   a. realizimin e procedurave për sigurimin dhe instalimin e pajisjeve, mjeteve dhe kapaciteteve infrastrukturore të miratuara;
   b. ngritjen, modernizimin, zgjerimin ose funksionalizimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor;
   c. krijimin e kushteve për përdorimin shkencor dhe aksesin e komunitetit kërkimor në infrastrukturën e financuar;
   d. realizimin e aktiviteteve të menaxhimit dhe koordinimit të projektit.
5. Fondet e financimit përdoren vetëm për qëllimet dhe kategoritë e shpenzimeve të miratuara në 25erform dhe në përputhje me planin financiar të përcaktuar në marrëveshjen e financimit. Institucioni përfitues mban përgjegjësi për menaxhimin e rregullt financiar, dokumentimin e shpenzimeve dhe përdorimin efektiv të fondeve publike.
6. Procedurat e prokurimit për pajisje, mallra, shërbime ose punime të nevojshme për realizimin e projektit kryhen nga institucioni përfitues në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin 25erfor, kur është I zbatueshëm, si dhe me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e financimit.
7. Institucioni përfitues është përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit 25erfor, financiar dhe 25erformances25e të projektit, si dhe për vënien në dispozicion të tij gjatë proceseve të monitorimit, kontrollit dhe vlerësimit nga AKKSHI ose strukturat e autorizuara prej saj.
8. Ndryshimet madhore të projektit, të cilat prekin objektivat, komponentët kryesorë, afatet ose strukturën financiare të miratuar, mund t'I nënshtrohen miratimit të 25erforman Administrimit të AKKSHI-së, me propozim të strukturave përgjegjëse të AKKSHI-së dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në marrëveshjen e financimit. Ndryshimet e tjera miratohen nga strukturat përgjegjëse të AKKSHI-së, sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e financimit

Neni 23
Monitorimi i projekteve PIKSH

1. AKKSHI monitoron zbatimin e projekteve PIKSH me qëllim verifikimin e progresit 25erfor dhe financiar, përputhshmërisë me projektin e miratuar dhe përdorimit të fondeve publike në përputhje me qëllimin e financimit.
2. Monitorimi kryhet gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit dhe bazohet në:
   a. raportet periodike të paraqitura nga institucioni përfitues;
   b. të dhënat dhe dokumentacionin mbështetës të projektit të shoqëruara, me dokumentacionin 25erformances25e, financiar e 25erfor;
   c. verifikimet administrative, financiare dhe teknike kur është e nevojshme;
   d. vizitat monitoruese në terren pas njoftimit nga përfituesi që infrastruktura kërkimore është blerë dhe është funksionale.
3. Në procesin e monitorimit vlerësohen, ndër të tjera:
   a. progresi në realizimin e aktiviteteve dhe objektivave të projektit;

b. realizimi I treguesve të 26erformances dhe rezultateve të pritshme;
c. përputhshmëria e shpenzimeve me buxhetin e miratuar;
d. funksionaliteti dhe përdorimi efektiv I infrastrukturës së financuar;
e. masat për garantimin e qëndrueshmërisë së investimit.

4. Monitorimi dhe vlerësimi I realizimit të projekteve PIKSH bazohet në indikatorë të matshëm të 26erformances (Key Performance Indicators – KPI), të cilët mundësojnë vlerësimin e progresit të zbatimit, efektivitetit të investimit dhe ndikimit të infrastrukturës së financuar. Ata përcaktohen në fazën e miratimit të projektit dhe përfshihen në marrëveshjen e financimit, duke shërbyer si bazë për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit të investimit Indikatorët e 26erformances përcaktohen në varësi të natyrës, objektivave dhe specifikave të secilit 26erform dhe mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:
   a. **shkallën e realizimit të investimit** – përqindjen e realizimit të aktiviteteve dhe shpenzimeve të miratuara në raport me planin fillestar të projektit;
   b. **funksionalizimin e infrastrukturës së financuar** – nivelin e instalimit, vënies në përdorim dhe funksionimit të pajisjeve, sistemeve ose kapaciteteve të krijuara;
   c. **numrin dhe profilin e përdoruesve të infrastrukturës** – numrin e studiuesve, institucioneve, grupeve kërkimore ose përdoruesve të tjerë që aksesojnë dhe përdorin kapacitetet e financuara;
   d. **numrin e institucioneve përfituese dhe partnere** – shkallën e bashkëpunimit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës ndërmjet institucioneve kërkimore dhe partnerëve të tjerë;
   e. **përdorimin nga sektori privat dhe industria** – nivelin e angazhimit të ndërmarrjeve, organizatave ose aktorëve të tjerë ekonomikë në përdorimin e infrastrukturës për kërkim, zhvillim dhe inovacion;
   f. **rezultatet shkencore të gjeneruara** – përfshirë publikimet shkencore, të dhënat kërkimore, rezultatet teknologjike ose produkte të tjera të krijuara si rezultat I përdorimit të infrastrukturës;
   g. **projektet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare të gjeneruara** – numrin e iniciativave, projekteve ose partneriteteve ndërkombëtare të mundësuara nga infrastruktura e financuar;
   h. **shërbimet kërkimore dhe teknike të ofruara** – numrin dhe llojin e shërbimeve të ofruara për komunitetin shkencor, institucionet publike ose sektorin privat;
   i. **qëndrueshmërinë financiare të infrastrukturës** – përfshirë të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi I infrastrukturës, kur është e aplikueshme, dhe kapacitetin për mbulimin e kostove të mirëmbajtjes dhe funksionimit;
   j. **shkallën e aksesit të hapur** – nivelin e aksesueshmërisë së infrastrukturës për komunitetin shkencor dhe përdoruesit e tjerë, në përputhje me parimet e aksesit të hapur dhe politikat përkatëse.
4. AKKSHI mund të kërkojë informacion shtesë, dokumentacion plotësues ose masa korrigjuese në rast të evidentimit të mospërputhjeve gjatë zbatimit të projektit.

Neni 24
Raportimi i projekteve PIKSH

1. Institucioni përfitues është I detyruar të paraqesë pranë AKKSHI-së raporte periodike dhe raport përfundimtar mbi zbatimin e projektit, në përputhje me afatet dhe formatet e përcaktuara në marrëveshjen e financimit.
2. Raportet duhet të përmbajnë informacion mbi:

a. aktivitetet e realizuara dhe progresin e projektit;
b. rezultatet dhe objektivat e arritura;
c. përdorimin e fondeve dhe realizimin financiar të projektit;
d. problematikat e hasura dhe masat e ndërmarra për zgjidhjen e tyre;
e. funksionalitetin, përdorimin dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës së krijuar.

3. Raporti përfundimtar duhet të dokumentojë përmbushjen e objektivave të projektit, rezultatet e arritura, ndikimin e investimit dhe mënyrën e përdorimit të infrastrukturës pas përfundimit të financimit.
4. Raporti përfundimtar I projektit hartohet dhe dorëzohet nga institucioni përfitues sipas modelit (template) të miratuar nga AKKSHI, I përfshirë në anekset e këtij Udhëzuesi, dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e financimit.
5. Mosparaqitja e raporteve 27erfor afateve të përcaktuara ose mosrealizimi I detyrimeve të raportimit mund të sjellë marrjen e masave të parashikuara në marrëveshjen e financimit dhe në kuadrin rregullator në fuqi.
6. AKKSHI administron, shqyrton dhe vlerëson raportet e paraqitura, duke dokumentuar rezultatet e monitorimit dhe zbatimit të projekteve PIKSH.

Neni 25
Vlerësimi i ndikimit të projekteve PIKSH

1. Pas përfundimit të zbatimit të projektit, AKKSHI kryen vlerësimin e ndikimit të projekteve të financuara në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), me qëllim vlerësimin e efektivitetit të investimit 27erfor dhe rezultateve të arritura.
2. Vlerësimi I ndikimit bazohet në rezultatet e raportit përfundimtar të projektit, të dhënat e monitorimit, treguesit e 27erformances dhe informacionin e ofruar nga institucioni përfitues.
3. Në kuadër të vlerësimit të ndikimit analizohen, ndër të tjera:
   a. shkalla e realizimit të objektivave dhe rezultateve të pritshme të projektit;
   b. funksionaliteti dhe përdorimi efektiv I infrastrukturës së financuar;
   c. ndikimi në rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe teknologjike të institucionit përfitues;
   d. kontributi në zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe aksesin e komunitetit shkencor në infrastrukturën e krijuar;
   e. rezultatet shkencore, teknologjike dhe institucionale të gjeneruara nga investimi;
   f. qëndrueshmëria e infrastrukturës dhe masat e ndërmarra për mirëmbajtjen dhe përdorimin afatgjatë të saj.
4. Për realizimin e vlerësimit të ndikimit, AKKSHI mund të përdorë tregues sasiorë dhe cilësorë të përcaktuar në dokumentacionin e thirrjes, marrëveshjen e financimit ose anekset e këtij Udhëzuesi.
5. Rezultatet e vlerësimit të ndikimit përdoren nga AKKSHI për:
   a. përmirësimin e skemave të financimit dhe procedurave të Programit PIKSH;
   b. orientimin e investimeve të ardhshme në infrastrukturën e kërkimit shkencor;
   c. raportimin institucional mbi efektivitetin dhe ndikimin e fondeve publike në kërkim dhe inovacion.

KAPITULLI V

KUADRI BUXHETOR I PROGRAMIT PIKSH

Neni 26

Burimet e financimit të Programit PIKSH

1. Programi i Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) financohet nga fondet e miratuara në buxhetin e shtetit për Agjencinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet përkatëse të miratuara nga Bordi i Administrimit.
2. Burimet e financimit të Programit PIKSH përfshijnë:
   a. fondet e buxhetit të shtetit të destinuara për kërkimin shkencor, zhvillimin teknologjik dhe inovacionin;
   b. bashkëfinancim nga institucionet përfituese ose partnerët e projektit, kur kjo parashikohet në thirrjen për aplikim;
   c. burime të tjera financiare të ligjshme, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.
3. Financimi i projekteve PIKSH akordohet nëpërmjet thirrjeve të hapura dhe konkurruese, bazuar në fondin e miratuar për secilën thirrje, rezultatet e procesit të vlerësimit dhe vendimin e Bordit të Administrimit të AKKSHI-së.
4. Shuma maksimale e financimit, intensiteti i financimit, kërkesat për bashkëfinancim, si dhe kushtet e përdorimit të fondeve përcaktohen në dokumentacionin e thirrjes për aplikim dhe në marrëveshjen e financimit.
5. Fondet e akorduara në kuadër të Programit PIKSH përdoren ekskluzivisht për realizimin e aktiviteteve dhe shpenzimeve të miratuara në projekt dhe administrohen në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës, eficiencës, efektivitetit, ekonomicitetit dhe llogaridhënies.

Neni 27
Buxheti i projektit, financimi dhe bashkëfinancimi

1. Çdo projekt-propozim duhet të shoqërohet me një buxhet të detajuar, të argumentuar dhe të balancuar, i cili pasqyron të gjitha shpenzimet e planifikuara për realizimin e projektit, sipas kategorive të përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes.
2. Buxheti i projektit duhet të jetë në përputhje me objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të projektit, duke respektuar parimet e ekonomicitetit, eficiencës, efektivitetit dhe përdorimit të përgjegjshëm të fondeve publike.
3. Shuma maksimale e financimit, kategoritë e shpenzimeve të pranueshme dhe të papranueshme, si dhe kufijtë përkatës, përcaktohen në dokumentacionin e secilës thirrje për aplikim dhe në nenet përkatëse të këtij Udhëzuesi.
4. Kur parashikohet në dokumentacionin e thirrjes, institucioni përfitues dhe/ose partnerët e projektit sigurojnë bashkëfinancim financiar dhe/ose kontribut në natyrë. Përqindja minimale e bashkëfinancimit, mënyra e llogaritjes dhe kërkesat për dokumentimin e tij përcaktohen në dokumentacionin e thirrjes.
5. Çdo ndryshim në buxhetin e miratuar gjatë zbatimit të projektit lejohet vetëm me miratimin paraprak të AKKSHI-së dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e financimit.

Neni 28
Administrimi financiar i projektit

1. Fondet e miratuara për projektin disbursohen nga AKKSHI në përputhje me marrëveshjen e financimit, planin e zbatimit të projektit dhe disponueshmërinë e fondeve buxhetore.
2. Përfituesi është përgjegjës për administrimin e fondeve të projektit në përputhje me legjislacionin në fuqi, kushtet e marrëveshjes së financimit dhe këtë Udhëzues, duke garantuar përdorimin e tyre vetëm për shpenzimet e miratuara dhe të pranueshme.
3. Çdo ndryshim ose rialokim i fondeve ndërmjet kategorive të buxhetit lejohet vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e financimit dhe me miratimin paraprak të AKKSHI-së, kur kërkohet.
4. Përfituesi paraqet raportet financiare periodike dhe raportin financiar përfundimtar, të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës që provon kryerjen dhe pagesën e shpenzimeve, sipas afateve dhe formatit të përcaktuar nga AKKSHI.
5. AKKSHI ka të drejtë të kryejë verifikime administrative, monitorim financiar dhe kontrolle gjatë zbatimit të projektit, si dhe të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë, kur e vlerëson të nevojshme.
6. Projektet e financuara mund t'i nënshtrohen auditimit financiar dhe kontrollit nga organet kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Në rast të konstatimit të përdorimit të fondeve në kundërshtim me marrëveshjen e financimit, këtij Udhëzuesi ose legjislacionit në fuqi, AKKSHI merr masat përkatëse, përfshirë pezullimin e financimit, ndërprerjen e marrëveshjes dhe kërkimin për kthimin e plotë ose të pjesshëm të fondeve, sipas procedurave ligjore në fuqi.

Neni 29
Kontrolli, auditimi, pezullimi dhe përfundimi i projekteve

1. AKKSHI ushtron kontrollin, monitorimin dhe verifikimin e zbatimit të projekteve të financuara në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), me qëllim garantimin e përputhshmërisë së zbatimit teknik dhe financiar me projektin e miratuar, marrëveshjen e financimit dhe kërkesat e përcaktuara në këtë Udhëzues.
2. Kontrollet administrative dhe verifikimet në terren kryhen nga strukturat përgjegjëse të AKKSHI ose persona të autorizuar prej saj dhe kanë për qëllim verifikimin e:
   a. realizimit të aktiviteteve dhe objektivave të projektit;
   b. përdorimit të fondeve sipas qëllimit dhe kategorive të miratuara të shpenzimeve;
   c. dokumentacionit teknik, financiar dhe administrativ të projektit;
   d. funksionalitetit dhe përdorimit të infrastrukturës së financuar.
3. Institucioni përfitues është i detyruar të sigurojë akses në dokumentacionin, mjediset, pajisjet dhe informacionin e nevojshëm për realizimin e kontrolleve, auditimeve dhe verifikimeve të kryera nga AKKSHI ose strukturat e autorizuara.
4. Në rast të konstatimit të mospërputhjeve, vonesave të pajustifikuara, mosrealizimit të detyrimeve të përcaktuara ose përdorimit të papërshtatshëm të fondeve, AKKSHI mund të kërkojë marrjen e masave korrigjuese, të pezullojë përkohësisht financimin ose, në raste të përcaktuara në marrëveshjen e financimit, të ndërpresë financimin e projektit

5. AKKSHI nuk ushtron funksione të auditimit financiar të fondeve të financuara në kuadër të Programit PIKSH. Auditimi financiar kryhet nga strukturat kompetente të institucionit përfitues, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose organe të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi.
6. Në rast të përdorimit të fondeve në kundërshtim me qëllimin e miratuar, të shpenzimeve të pajustifikuara ose të fondeve të pashfrytëzuara sipas kushteve të financimit, kërkohet rikuperimi i shumave përkatëse nga institucioni përfitues, në përputhje me marrëveshjen e financimit dhe legjislacionin në fuqi.
7. Në përfundim të projektit, institucioni përfitues paraqet raportin përfundimtar sipas modelit (template) të miratuar nga AKKSHI dhe të përfshirë në anekset e këtij Udhëzuesi. Raporti përfundimtar përmban informacion mbi realizimin e aktiviteteve, arritjen e objektivave, rezultatet e projektit, përdorimin e fondeve, treguesit e performancës (KPI), funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e infrastrukturës së financuar.
8. AKKSHI shqyrton raportin përfundimtar, vlerëson përmbushjen e detyrimeve të projektit dhe, pas pranimit të rezultateve dhe përmbushjes së kërkesave financiare e administrative, kryen mbylljen administrative dhe financiare të projektit.
9. Procedurat për kontrollin, verifikimin në terren, pezullimin, ndërprerjen e financimit, rikuperimin e fondeve dhe mbylljen e projektit përcaktohen në marrëveshjen e financimit dhe zbatohen në përputhje me këtë Udhëzues dhe legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI VI

KONFLIKTI I INTERESIT DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 30
Konflikti i interest

1. Të gjithë personat e përfshirë në procesin e vlerësimit të projekt-propozimeve, përfshirë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit, ekspertët e jashtëm dhe çdo person tjetër të angazhuar në këtë proces, janë të detyruar të respektojnë parimet e paanshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit.
2. Përpara fillimit të procesit të vlerësimit, personat e përfshirë deklarojnë çdo situatë të mundshme konflikti interesi, ku një interes personal, profesional, institucional ose financiar mund të ndikojë ose të krijojë perceptimin e ndikimit në objektivitetin dhe pavarësinë e vlerësimit.
3. Personat që rezultojnë në konflikt interesi nuk marrin pjesë në shqyrtimin, diskutimin ose vlerësimin e projekt-propozimit përkatës dhe zëvendësohen sipas procedurave të përcaktuara nga AKKSHI.
4. Të gjithë personat e përfshirë në proces janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të siguruar gjatë vlerësimit, përfshirë përmbajtjen e projekt-propozimeve, dokumentacionin teknik dhe financiar, raportet e ekspertëve dhe diskutimet e procesit të vlerësimit.
5. Deklaratat e konfliktit të interesit dhe konfidencialitetit dokumentohen dhe administrohen nga AKKSHI, ndërsa detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pas përfundimit të procesit të vlerësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e përcaktuara në këtë Udhëzues.

Neni 31
Konfidencialiteti

1. Të gjithë personat e përfshirë në procesin e administrimit, vlerësimit, monitorimit dhe auditimit të projekteve PIKSH janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe dokumentacionit të projektit, si gjatë procesit ashtu edhe pas përfundimit të tij.
2. Informacioni dhe dokumentacioni i projektit përdoren vetëm për qëllimet e administrimit, vlerësimit, monitorimit dhe kontrollit të projektit dhe nuk u bëhen të ditura palëve të treta, përveç rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zbatohet për ekspertët vlerësues, punonjësit e AKKSHI-së, anëtarët e komisioneve, auditorët dhe çdo person tjetër që ka akses në dokumentacionin e projektit.
4. Shkelja e detyrimeve për konfliktin e interesit ose konfidencialitetin trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mund të sjellë përjashtimin nga procesi, ndërprerjen e angazhimit ose masa të tjera administrative dhe ligjore.

KAPITULLI VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 32
Interpretimi dhe zbatimi i Udhëzuesit

1. Interpretimi i dispozitave të këtij Udhëzuesi bëhet nga AKKSHI/NASRI, në përputhje me qëllimin e Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH), legjislacionin në fuqi dhe parimet e menaxhimit transparent dhe efektiv të fondeve publike.
2. Në rast paqartësish ose mospërputhjesh në zbatimin e dispozitave të këtij Udhëzuesi, AKKSHI nxjerr udhëzime ose përcaktime sqaruese, sipas kompetencave të përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator.

Neni 33
Çështje të paparashikuara

1. Për çështjet që nuk janë të parashikuara shprehimisht në këtë Udhëzues, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi, marrëveshjes së financimit dhe dokumentacionit të thirrjes për aplikim.
2. Në raste të veçanta që kërkojnë interpretim ose rregullim procedural, AKKSHI merr masat përkatëse në përputhje me kompetencat e saj dhe parimet e transparencës, barazisë së trajtimit dhe përdorimit të përgjegjshëm të fondeve publike.

Neni 34
Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzues hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, sipas kuadrit ligjor dhe institucional në fuqi.
2. Pas hyrjes në fuqi, Udhëzuesi publikohet në faqen zyrtare të AKKSHI dhe zbatohet për thirrjet për aplikim të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH) të zhvilluara pas datës së hyrjes në fuqi.

KAPITULLI VIII

ANEKSET E UDHËZUESIT

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzuesi janë anekset e mëposhtme, të cilat përcaktojnë formatet standarde, modelet dhe dokumentet mbështetëse për zbatimin e procedurave të aplikimit, vlerësimit, miratimit, financimit, monitorimit dhe raportimit të projekteve në kuadër të Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor (PIKSH).

Lista e Anekseve për aplikantët është si më poshtë:

Aneksi 1. Formulari standard i aplikimit
Aneksi 2. Modeli standard i buxhetit të projektit
Aneksi 3. Deklarata e angazhimit
Aneksi 4. Deklarata e mosfinancimit të dyfishtë
Aneksi 5. Plani i detajuar i punës. Kalendari i zbatimit të projektit

Lista e Anekseve për Vlerësuesit dhe AKKSHI është si më poshtë:

Aneksi 6. Deklarata e konfliktit te interest dhe paanshmerise
Aneksi 7. Formulari i vlerësimit shkencor, teknik dhe financiar nga ekspertët
Aneksi 8. Matrica e kritereve dhe pikëzimit të vlerësimit
Aneksi 9. Formati standard i raportit teknik të progresit dhe raportit përfundimtar
Aneksi 10. Formati standard i raportit financiar
Aneksi 11. Lista e shpenzimeve të pranueshme dhe të papranueshme
Aneksi 12. Lista e treguesve të performancës dhe monitorimit (KPI)
Aneksi 13. Lista e dokumenteve të detyrueshme për aplikim
Aneksi 14. Lista e kontrollit administrativ të aplikimeve (Administrative Check List)
Aneksi 15. Struktura e kodit të projektit PIKSH

AKKSHI mund të përditësojë, plotësojë ose ndryshojë modelet dhe formatet e anekseve, në varësi të natyrës së thirrjes për aplikim, kërkesave të programit dhe nevojave të menaxhimit të procesit, duke garantuar transparencë dhe njoftim të aplikantëve.